



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY JUNIK

Zyra e Prokurimit - Komuna Junik

Datë: 02.09.2020

Në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 108/A, paragrafi 6 dhe 10, pika 10.1 dhe Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: 24.08.2020, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim (ankesës) të parashtruar nga grupi i Operatorëve Ekonomik, "Arfa Group". sh. p. k dhe "Euroasphalt". sh. p. k, Deçan, Gjakovë, të datës: 31.08.2020, lidhur me tenderin "Ndërtimi i rrugës Junik - Gjeravicë", me numër të brendshëm të prokurimit: 636-19-022-511 dhe me numër të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1, të shpallur me dt. 17.07.2019, Zyra e Prokurimit mori këtë:

VENDIM

- I. Refuzohet si e pabazë kërkesa për ri-shqyrtim (ankesa) nga grupi i Operatorëve Ekonomik, "Arfa Group". sh. p. k dhe "Euroasphalt". sh. p. k, e parashtruar me datën: 31.08.2020, lidhur me tenderin: "Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë", me numër të brendshëm të prokurimit: 636-19-022-511 dhe me numër të prokurimit: 636-19-5225-5-1-1.
- II. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Komuna Junik i datës: 24.08.2020.
- III. Ky vendim hyn në fuqi pas ditës së nënshkrimit të këtij vendimi.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik, shqyrtoi kërkesën për ri-shqyrtim të datës: 31.08.2020, të pranuar përmes sistemit elektronik E-Prokurimi e parashtruar nga grupi i Operatorëve Ekonomik, "Arfa Group". sh. p. k dhe "Euroasphalt". sh. p. k, Deçan, Gjakovë duke analizuar të gjitha faktet e ofruara nga grupi i operatorëve ekonomik në fjalë dhe bazuar në neni 108/A, paragrafi 10, pika 10.1, të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, të njëjtën e refuzoi si të pa bazuar për këto arsye:

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë në web faqen zyrtare të E-Prokurimit.

Provë: Njoftimi i Publikuar në web faqen zyrtare të E- Prokurimit.

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me ri-vlerësimin e lëndës me titull: "Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë", Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik ka pranuar kërkesë për qasje në dokumnetacionin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe qasja ju ka lejuar ashtu siq parashihet në nenin 10, paragrafi 3 dhe 5 të Ligjit për Prokurim Publik në fuqi.

Me datën: 31.08.2020, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik, ka pranuar kërkesën për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit në fjalë dhe menjëherë ka pezulluar aktivitetin e prokurimit.

Provë: Njoftim për pezullim

Në vazhdim ashtu siç parashihet në neni 108/A, paragrafi 10, pika 10.1, të Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik jep përgjigje me shkrim parashtruesit të ankesës, grupit të Operatorëve Ekonomik, "Arfa Group". sh. p. k dhe "Euroasphalt". sh. p. k, Deçan, Gjakovë lidhur me pretendimet e bëra në kërkesën për ri-shqyrtim (ankesën) :

Pas Urdhresës së OSHP-së me nr.rendor 272/20, të pranuar me datën: 12.06.2020, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik, ka kthyer lën në ri- vlerësim dhe ka vepruar konform kësaj Urdhresës nr. 272/20.

Provë: Urdhëresa nr.272/20

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik ka ri- vlerësuar këtë aktivitet të prokurimit duke u bazuar në paragrafin III, IV dhe V, të Urdhresës së OSHP- së me numër rendor 272/20, ku me këtë urdhëresë obligohet Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik të respektoj vendimin e datës: 18.03.2020 me nr. 100/111/20 nga Organi Shqyrtues i Prokurimit- Paneli Shqyrtues i emëruar nga Kryetari i OSHP- së, që aktiviteti i prokurimit me titull: Ndërtimi rrugës Junik- Gjeravicë të ri-vlerësohet. Me datën: 17.06.2020, Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik e respektoi Urdhresën me nr.272/20 të OSHP- së dhe e formoi komisionin e ri për ri-vlerësimin e lëndës me titull: Ndërtimi i rrugës Junik- Gjeravicë si dhe duke u bazuar në paragrafi III, IV dhe V të kësaj urdhërese (për respektimin e Vendimit nr.100/111/20) të Organit Shqyrtues të Prokurimit- Panelit Shqyrtues, ankesa juaj kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- Komuna Junik hidhet poshtë si e pabazuar përderisa Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik nuk ka panuar Njoftim nga OSHP- ia për heqjen tuaj nga lista e zezë e operatorëve ekonomik.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e paraqitura, AK nuk ka bërë asnjë prej shkelje të neneve të pretenduar nga ana juaj sepse ne si AK nuk mund të dalim mbi vendimet e një organi më të lartë siq është OSHP- ia (Urdhëresa dhe Vendimet e OSHP- së), konkretisht nuk mund të veprojmë ndryshe nga Urdhëresa e OSHP- së, ku në atë urdhëresë nuk jemi njoftuar dhe as me ndonjë formë tjetër nga OSHP- ia se ju nuk jeni më në listë të zezë dhe mund të vazhdoni me aktivitetin e prokurimit në fjalë.

Autoriteti Kontraktues- Komuna Junik bazuar në nenin 4, paragrafin 1.26 të Ligjit të Prokurimit Publik në fuqi si dhe duke marrë në konsideratë Urdhresën me numër rendor 272/20 të Organit Shqyrtues të Prokurimit- Panelit Shqyrtues për këtë aktivitet të prokurimit refuzon kërkesën tuaj për rishqyrtimin e lëndës në fjalë.

Provë: Urdhëresa e OSHP- së 272/20

Vendimi i OSHP 100/111/20

Njoftim mbi vendimin e AK

Vendimi ndaj kërkesës për ri-shqyrtim:31.08.2020

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të parashtroi ankesë konform Ligjit të Prokurimit Publik Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 109 pika 2 në OSHP.

U.D.Zyrtare Përgjegjëse e Prokurimit:

Aktvendimi ti dorëzohet:

- Zyrës së Prokurimit
- Grupi i OE," Arfa Group". sh. p. k dhe "Euroasphalt". sh. p. k
- Arkivit të Komunës